



100 Vjet Pavarësi

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2145, datë 29.08.2012**

**Për**

**“Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Atel sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 2118, datë 4.7.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtarë” dhe Vendimin nr. 2122, datë 4.7.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 29.08.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Atel sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 2118, datë 04.7.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtarë” dhe Vendimin nr. 2122, datë 04.7.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese””.**

## BAZA LIGJORE:

- Pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
- Neni 137, e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
- Pika 17, e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim nr. 170, datë 24.04.2004 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të Ligjit nr. 9918;
- Rregulloren për Analizën e Tregut Nr. 9 , Date 17. 07. 2009.

## K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Atel sh.p.k. me nr. 30/07 Prot., datë 30.7.2012 (nr. 1635 Prot. i AKEP, datë 2.8.2012) për anulimin e Vendimit nr. 2118, datë 4.7.2012, “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtarë” dhe Vendimin nr. 2122, datë 04.7.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese””.
2. Vendimi nr. 2118, datë 04.7.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtarë”;
3. Vendimi nr. 2122, datë 04.7.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”
4. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);  
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

- I. Atel sh.p.k., me anë të shkresës nr. 30/07 Prot., datë 30.7.2012, shpreh shqetësimin dhe i konsideron të paligjshme këto dy vendime duke i kundërshtuar dhe kërkon anulimin e tyre duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe argumentat e mëposhtme:
  1. Në bazë të nenit 31 e vijues të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, AKEP është organi kompetent për të kryer analizën e tregut dhe për të vendosur në vijë detyrimin ndaj operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg në mbështetje të konkurrencës efektive në tregun përkatës.
  2. Referuar rregullores nr. 9, datë 17.07.2009 të AKEP, AKEP i rishikon përfundimet dhe vendimet e tij kur gjykon se faktet që cuan në marjen e vendimeve të mëparëshme për përcaktimin dhe analizën e tregjeve kanë

- ndryshuar dhe nuk pasqyrojnë situatën reale ne treg. AKEP gjithashtu duhet të marrë në konsideratë direktivat, udhëzimet, rekomandimet e BE mbi analizat e tregjeve dhe vlersimin e FNT sipas kuadrit rregullator të BE në fushën e komunikimeve elektronike.
3. Në vendimin nr. 2122, datë 04.07.2012 të AKEP dhe analizën përkatëse nuk parashikohet asnjë lloj arsyetimi, analize apo komenti mbi faktet që kanë ndryshuar drejt një konkurrence efektive e cila të mos e justifikojë me detyrimin e FNT për rregullimin e tarifave të terminimit për thirrjet hyrëse ndërkombëtare. Parashikimet e AKEP në Analizën lidhur me shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare për të cilat nuk ka operator FNT apo trajtim nga KE i roamingut ndërkombëtar nuk janë argumenta që tregojnë ndryshim të situatës referuar analizës së mëparëshme të datës 31.03.2012.
  4. Vendimi i AKEP për diferencimin në trajtimin e tarifës së terminimit sipas origjinimit së thirrjeve nuk është i bazuar në ligj. Sipas ligjit AKEP mund të heqi detyrimet për tarifatat ndaj FNT vetëm në bazë të analizës së tregut dhe në rast se arrin në përfundim se konkurrenca në treg është efektive.
  5. Nisur nga analiza e AKEP i muajt mars 2010, operatorët FNT duhet të aplikojnë të njëjtën tarifë terminimi për thirrjet që përcjellin në rrjetin e tyre pavaresisht origjinës, kombëtare apo ndërkombëtare të përdorusëve fundor qoftë të tyre qoftë të operatorëve të tjerë. Për terminimin e thirrjeve, operatori kryen shërbimin e transportit të thirrjes nga pika e interkoneksionit deri në pikën fundore në rrjetin e vet. Diskriminimi në tarifën e terminimit sipas origjinimit së thirrjes nuk është i justifikuar as nga kostot e këtij shërbimi dhe do të ishte i paqëndrueshëm ( i pazbatueshëm) nëse operatorët të cilët paguajnë terminimin më të lartë, do të kishin mundësi të rrugëzonin thirrjen nëpërmjet një operatori tjetër më të ulët. AKEP tregun aktualisht e ndanë në varësi të origjinës së thirrjes dhe heq detyrimin e rregullimit të tarifës për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, pa dhënë asnjë argument ligjor dhe pa arsyetuar sipas kushteve të konkurrencës apo ndryshimeve në fakte, të cilat sipas rregullores nr. 9/2009 do të mund të përlligjin një ndarje të tillë.
  6. AKEP nuk mund të dal nga parashikimet e rregullores që ka miratuar vet, për më tepër kur nuk ka fakte, argumente dhe të bëj një ndarje të tillë pas dy vjetësh, të pa bazuar në asnjë akt ligjor.
  7. Në bazë të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 322, datë 05.05.2010, AKEP-it i jepet fuqia të heq detyrimet rregullatore kur konkurrenca e qëndrueshme të jetë arritur. Në kuadër të integritimit në BE, dokumenti i politikave parashikon se është shumë e rëndësishme që vendimet e AKEP të jenë të bazuara sa më shumë të jetë e mundur.
  8. Argumentat e përdorura nga AKEP në analizën e tregut mobile nuk kanë lidhje me terminimin në rrjetin e operatorit. Referencat për *roaming-un* në vendet e BE nuk mund të shërbejnë si model për terminimin, ndërkohe nuk flitet fare se si është rregulluar kjo gjë në vendet e BE, në referencën e bërë në analizë me raportin e muajt mars 2012, nuk mund të shërbej si e tillë sepse kuadri ligjor dhe ai rregullator kanë referencë rekomandimet e BE të cilat nuk parashtrajnë një zgjidhje dhe klasifikim të tillë të terminimit.

9. Vendimi nr. 2122/2012 i AKEP nuk është i bazuar në vlersimin e një konkurrence efektive dhe të qëndrueshme, dhë madje vetë AKEP shprehet në analizën e tregut se konkurrenca nuk është ende efektive. AKEP nuk ka paraqitur në vendim asnjë fakt mbi të cilin e bazon masën e tij për heqjen e rregullimit të tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Në referencën që AKEP bën, parashikon se terminimi i thirrjeve i përket tregut të terminimit, pa përcaktuar ndarjen sipas origjinës së thirrjeve.
10. AKEP me këtë analizë që në fakt nuk përmban asnjë analizë sipas kërkesave ligjore për përcaktimin e tregut dhe heqje detyrimesh për FNT, bie në kundësthim me të gjitha përfundimet dhe arsyetimet e nxjerra dhe përdorura po nga vetë AKEP në analizën e mëparshme.
11. AKEP duhet të marrë parasysh faktorin e aftësisë imponuese që kanë OFNT në strukturat e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre. Ndër faktorët dhe kriteret e konsideruar më të rëndësishëm për tregjet e terminimit janë konkurrenca e mundëshme fuqia kundërvepruese e blerësve të shërbimit dhe tarifimi i shërbimit të terminimit.
12. Duke u mbështetur sa me lart, i kërkojme AKEP që të anulojë Vendimin nr. 2118 datë 04.07.2012 “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtar” dhe vendimin nr.2122, datë 04.07.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, të nxjerra nga Këshilli Drejtues AKEP.

**II.** AKEP vlerëson se, pretendimet e parashtruara në kërkesën ankimore nga ana e sipërmarrësit Atel sh.p.k, nuk janë të drejta dhe të bazuara ligjërisht, pasi:

1. Vendimet e KD të AKEP, nr.2118 dhe VKD nr.2112, datë 04.07.2012 të ankimuara nga Atel janë bërë të munduara pas një procesi konsultimi mbi dokumentin e analizes të radhës, analizë e cila në mënyrë të detajuar ka bërë trajtimin e trafikut ndërkombëtar hyrës, duke sjellë në vëmendje edhe historikun e tij në mënyrën e trajtimit dhe të vendimarrjeve në kohë të ndryshme për këtë shërbim. Por në të gjitha rastet nuk është lënë jashtë sqarimit mundësia e përdorimit të dy alternativave të ndryshme në trajtimin e trafikut ndërkombëtar hyrës dhe për këtë qëllim edhe në dokumentet e mëparshme AKEP ka referuar argumente “pro” dhe “kundër” rregullimit apo de-rregullimit për trafikun ndërkombëtar hyrës.

Pesha e këtyre argumenteve në kohë të ndryshme të trajtimit dhe analizës së kryer mund të jetë e ndryshme. Në analizën e radhës janë vlerësuar dhe trajtuar në mënyrë të detajuar historiku i trajtimit të trafikut ndërkombëtar hyrës, por arsyet themelore që kanë bërë të mundur de-rregullimin e trafikut ndërkombëtar hyrës janë:

- a) Vlerësimi i drejtë i raportit kërkesë/ofertë për shërbimin e terminimit të trafikut ndërkombëtar hyrës, e arsyetuar në mënyrë të detajuar në dokumentin e analizës;

- b) Vlerësimi i faktit që terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombetare shërben si input për operatorët në vende të tjera (tregjet me pakice në këto vende) për të ofruar thirrje drejt abonentëve të këtij rrjeti, duke mos sjellë impakt në tregjet me pakicë në Shqipëri;
- c) Vlerësimi i faktit që kryesisht në dy vitet e fundit shumica e operatoreve alternativë (në mungesë të plotë të kapaciteteve për të ofruar shërbimin e tranzitimit të thirrjeve ndërkombetare hyrëse), vendosën në fokus të aktivitetit të tyre vetëm shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombetare, vetëm për interesa fitimi, duke mos sjelle asnjë stimul pozitiv në ndërtimin dhe zhvillimin e rrjeteve të telefonisë fikse për pajtimtarët fundor në Republikën e Shqipërisë dhe duke u identifikuar qartë si shkaktar kryesorë të rënies së cilësisë së shërbimit për përdoruesin fundor. Një fakt i tillë është i pakontestueshëm, pasi AKEP ka investuar në vijimësi për zgjidhje mos-marrëveshjesh ndërmjet operatoreve tranzitues të trafikut ndërkombetar hyrës dhe operatoreve që ofrojnë shërbimin e terminimit në rrjetet e tyre, ndaj të cilëve rëndon edhe përgjegjësia për cilësinë e shërbimit të ofruar pajtimtareve të rrjeteve të tyre.
- d) Vlerësimi i faktit të rëndësishëm që në tregun e tranzitimit të trafikut ndërkombëtar nuk ka asnjë operator me fuqi të ndjeshme, dhe për rrjedhojë ofruesit e këtij shërbimi do të ishte e drejte dhe parimore, të shfrytëzojnë mundësitë që të ofrojnë hapësirat kontraktuale dhe liria ekonomike e tregut, gjë e cila nuk kushtezohet nga vendimarrjet e AKEP;
2. Të gjitha argumentat e sjella nga ankimesi në mbështetje të ankimit janë pjesë e arsytimit dhe argumenteve të përdorura në dokumentin e analizës nga vetë AKEP, në kohë të ndryshme dhe në kushte dhe rrethana të caktuara të përdorura në trajtimin e trafikut ndërkombëtar hyrës, në transparencë të plotë dhe nëpërmjet konsultimeve të vazhdueshme me palët e interesit, konform përcaktimeve ligjore;
3. Për sa parashtrohet nga ankimesi në lidhje me këto dy vendime, argumentet e paraqitura me shkresën nr. 30/07 prot, datë 30.07.2012 nuk janë të mjaftueshme dhe të mbështetura për të iniciuar ndryshimin e qëndrimit rregullator të AKEP në lidhje me dy aktet e nxjerra prej tij;
4. Duke patur parasysh përcaktimin ligjor sipas pikes 1 të nenit 42 të ligjit nr. 9918 sipas të cilit:

*“AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për akses dhe interkoneksion, si dhe për përdorimin e elementeve të veçanta të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në veçanti, në ato raste kur AKEP-i vlereson se nga refuzimi i aksesit ose nga termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qendrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë”*

Që nënkupton se, nëse në një treg përkatës nuk ekzistojnë këto kondita ligjore, AKEP, nuk vendos këte detyrim, si dhe bazuar në konkluzionet e analizës së tregut përkatës për mos përfshirjen e trafikut ndërkombëtar hyrës në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular, gjë e cila nuk pengon konkurrencën e qendrueshme në tregun e pakicës dhe nuk dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë, rezulton se vendimi i AKEP-it i ankimuar sa më sipër, është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, pika a, të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

## **V E N D O S:**

1. Rrëzimin e ankimimit administrativ të Atel sh.p.k, me nr. 30/07 Prot., datë 30.7.2012, për “Anullimin e Vendimit nr. 2118 datë 04.07.2012 “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtar” dhe anulimin e vendimit nr. 2122, datë 04.07.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese””;
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 2118 datë 04.07.2012 “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtar” dhe Vendimit nr. 2122, datë 04.07.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.
3. Të njoftohet Atel sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## **ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE